

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

BizLink limited

NENI 1

FORMIMI

Sot me date 06.12.2023 themeluesit qe firmosin me poshte:

1. **Z.Nikolin Kovaçi** , shtetas shqiptar, i datëlindjes 11.01.2000 lindur në Lushnjë, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.Personal: **K00111082C**.

Ne baze te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 „Per Tregetarët dhe Shoqerite Tregëtare „, si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 “Per Qendren Kombëtare te Rregjistrimit “ themeloj me vullnet te lire shoqerine tregëtare me pergjegjesi te kufizuar ,me emertim **BizLink limited**.

NENI 2

SELIA

Selia e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **BizLink limited**, me adrese, Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga e Kavajës, Kompleksi Skënderbej Shkalla 6 Kati 2 Tiranë . Shoqeria ka te drejte te hape filiale ne te gjithë vendin.

NENI 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **BizLink limited** eshte pa afat nga momenti i regjistrimit te saj prane QKB Tirane.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë **BizLink limited** është:

Blerja, zhvillimi, shitja dhe dhënia me qera e pasurive te paluajtshme; Sherbime te akomodimit fjetje ditore, ambiente me qera ditore; Aktivitet tregtare ne fushen e hotelerisë, organizim eventesh te ndryshme.; Sherbime ne promovimin e aktiviteteve turistike; Organizim evente sociale dhe kulturore; Menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Dhënie me qira, nen qira te ambienteve te ndryshme. Aktivitet ne fushen e projektimit te godinave civile, mirembajtje dhe restaurim të objekteve te ndryshem. Organizimi i eventeve, publikime, reklama dhe fushata reklamuese, si dhe organizim tjeter. Konsulence te ndryshme tregtare te personave fizik dhe juridik perfshire institucione financiare dhe ato shtetërore. Investime ne fushën e ndërtimit dhe tregtimit brenda dhe jashtë vendit te pasurive te paluajtshme.

Kerkim dhe gjetje te tregjeve dhe klienteve si edhe gjetje te furnitoreve per furnizimet me dherbime dhe/ose me lende te para; komisioner tregtar.

Krijim, zhvillim, zyra ndërmjetësimi ne kryerjen e transaksioneve per pasurite e paluajtshme tregëtare midis paleve,promovimi i pasurive te paluajtshme. Aktivitet ne fushën e pasurive të patundshme, angazhimin dhe pregatitja e procedurave ligjore ne shitjen me shumicë dhe pakice të çdo lloj pasurie. Ndërmjetësim ne lidhje me shitje të produkteve të ndryshme.

Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 5
KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqërisë **BizLink limited** është **1,000 leke** dhe i ndare ne 1 kuota me kontributin e ortakut si me poshtë:

1. Një kuote **Z. Nikolin Kovaçi** masën 100 % (Një qind për qind) te kapitalit themeltar.

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga themeluesi, ata mund të ndryshojnë sipas vendimit që mund të marrin ortakët , por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 6
ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese te shoqërisë **BizLink limited** janë:

- Asambleja e Ortakeve ,organi me i larte vendim marres
- Administrator te shoqerise jane :
Z. Nikolin Kovaçi me nr. personal **K00111082C** Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet, nga data **06/12/2023** deri ne **06/12/2028**.

Administratoret veprojnë te pavarur nga njeri tjetri dhe kane kopetenca te plota, te pa kufizuara, ne zbatim te statutit dhe ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 7

Organizimi i shoqerise ,marredheniet me persona fizik e juridike, vendas apo te huaj ,shprehen ne status qe bashke me aktin themelimit jane dokumentat baze te veprimtarise dhe sherbejne per zhvillimin e marredheneve ne kete shoqeri.

NENI 8

Veprimtarine e saj ,shoqeria do te zhvilloje ne perputhje me legjislacioni Shqiptar.

NENI 9

Te gjitha mosmarreshjet me persona fizike ose juridik si dhe me organet shteterore zgjidhen me mirekuptim , me ane te dispozitave te ketij akti ,statuti si dhe legjislacioni shqiptar dhe kur keto mjete nuk japin rezultat atehere zgjidhen me gjykate

Ky akt themelimi hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te shoqerise me përgjegjësi te kufizuar **BizLink limited** në QKB ne këtë dite shoqëria **BizLink limited** njihet si person juridik

ORTAKU I VETEMI I SHOQERISE
Z. Nikolin Kovaçi

Nikolin Kovaçi

